



Water and Waste Regulatory Office
Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
Regulatorni Ured za Vodu i Otpad



ZRRUM – R 04 / SWC

ZYRA RREGULLATORE E UJIT DHE MBETURINAVE (“ZRRUM”)

RREGULL

PËR

KARTËN E KONSUMATORËVE

**PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE
NË KOSOVË**

26 Janar 2005

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA 1	DISPOZITAT E PËRGJITHSHME.....	6
Kapitulli 1	Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicioni.....	6
	Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull.....	6
	Neni 2 : Fushëveprimi.....	6
	Neni 3 : Qëllimi.....	6
	Neni 4 : Definicionet.....	6
	Neni 5 : Rregullat e Interpretimit.....	10
Kapitulli 2	Aplikueshmëria	10
	Neni 6 : Aplikueshmëria	10
PJESA 2	PARIMET E PËRGJITHSHME.....	10
Kapitulli 1	Parimet Elementare	10
	Neni 7 : Mirëbesimi	10
	Neni 8 : Njohja nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	10
	Neni 9 : Njohja nga Konsumatori	10
	Neni 10 : Mos-Diskriminimi.....	11
PJESA 3	TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË KONSUMATORËVE.....	11
Kapitulli 1	Të drejtat e Konsumatorëve.....	11
	Neni 11 : E Drejta për të marrë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave	11
	Neni 12 : E Drejta për t'u Informuar.....	11
	Neni 13 : Karta e Konsumatorëve.....	12
	Neni 14 : E Drejta për Qasje në të Dhënat e Konsumatorëve.....	12
	Neni 15 : Faturimi Transparent.....	12
	Neni 16 : Mbrojtja e të Dhënave Personale të Konsumatorëve dhe Informacioneve të Pronësisë	12
	Neni 17 : Identifikimi i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	12
	Neni 18 : E Drejta e Ankesës	12
	Neni 19 : Gjuha e Komunikimit.....	13
Kapitulli 2	Obligimet e Konsumatorëve.....	13
	Neni 20 : Lidhja e Kontratës së Shërbimit.....	13
	Neni 21 : Bashkëpunimi për Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave	13
	Neni 22 : Pagesa e Faturave	14
	Neni 23 : Qasja në Pronë.....	14
	Neni 24 : Pagesa e Borxheve të Vjetra.....	14
	Neni 25 : Respektimi i Pasurive të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave	14
	Neni 26 : Shfrytëzimi Ekskluziv i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave	15
	Neni 27 : Ndryshimet në Fakte dhe Rrethana	15

PJESA 4 TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE..... 15

**Kapitulli 1 Të Drejtat e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
15**

Neni 28 : E Drejta e Faturimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave	15
Neni 29 : E Drejta për të Pranuar Pagesën	15
Neni 30 : Të Drejtat Lidhur me të Dhënat Personale dhe Informatat Pronësore të Konsumatorëve	15
Neni 31 : Ekskluziviteti i Zonës së Shërbimit.....	16
Neni 32 : Shfrytëzimi i Aseteve të Domenit Publik.....	16
Neni 33 : Qasja në Godina	16

**Kapitulli 2 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
16**

Neni 34 : Pajtueshmëria me Kushtet e Licencës së Shërbimit.....	16
Neni 35 : Ofrimi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	16
Neni 36 : Faturimi i Konsumatorëve.....	17
Neni 37 : Veprimtaritë Afariste të Pa-Autorizuara	17
Neni 38 : Menaxhimi i Ankesave.....	17
Neni 39 : Ofrimi dhe Shpërndarja e Informatave.....	17
Neni 40 : Shfrytëzimi i Aseteve në Pronësi Publike	17
Neni 41 : Obligimet për Informim dhe për Raportim	17

PJESA 5 KARTA E KONSUMATORËVE 18

Kapitulli 1 Përgatitja dhe Përmbajtja..... 18

Neni 42 : Përgatitja e Kartës së Konsumatorëve.....	18
Neni 43 : Përmbajtja e Kartës së Konsumatorëve.....	18
Neni 44 : Gjuha e Kartës së Konsumatorëve	18
Neni 45 : Shqyrtimi i Kartës së Konsumatorëve nga ana e Rregullatorit.....	18

Kapitulli 2 Lëshimi i Kartës së Konsumatorëve..... 19

Neni 46 : Shtypja e Kartës së Konsumatorëve.....	19
Neni 47 : Shpërndarja e Kartës së Konsumatorëve.....	19
Neni 48 : Shpenzimet e Përgatitjes, Shtypjes dhe Shpërndarjes të Kartës së Konsumatorëve	19

Kapitulli 3 Modifikimi dhe Ri-lëshimi i Kartës së Konsumatorëve..... 20

Neni 49 : Modifikimi i Kartës së Konsumatorëve	20
Neni 50 : Lëshimi i Kartës së Modifikuar të Konsumatorëve	20
Neni 51 : Ri-lëshimi i Kartës së Konsumatorëve.....	20

PJESA 6 KONTRATA E SHËRBIMIT 20

Neni 52 : Përmbajtja e Kontratës së Shërbimit	20
Neni 53 : Shqyrtimi i Rregullatorit të Projekt Kontratës së Shërbimit	20
Neni 54 : Modifikimi i Kontratës së Shërbimit.....	21

PJESA 7 REGJISTRI I KONSUMATORËVE 21

Kapitulli 1	Regjistri i Konsumatorëve.....	21
	Neni 55 : Regjistrimi i Konsumatorëve	21
	Neni 56 : Përbajtja e Regjistrit të Konsumatorëve.....	22
	Neni 57 : Formati i Shënimeve në Regjistrin e Konsumatorëve.....	23
Kapitulli 2	Siguria e të Dhënave të Ruajtura në Regjistrin e Konsumatorëve.....	23
	Neni 58 : Siguria dhe Mbrojtja e të Dhënave të Konsumatorëve	23
PJESA 8	FATURAT PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE.....	24
Kapitulli 1	Fatura e Konsumatorëve – të Përgjithshme	24
	Neni 59 : Fatura e Konsumatorëve – të Përgjithshme.....	24
	Neni 60 : Gjuha dhe Shpërndarja e Faturës	24
	Neni 61 : Përbajtja e Faturës së Konsumatorëve	25
Kapitulli 2	Faturat për Llogaritë e Shumëfishta	26
	Neni 62 : Faturimi i Konsumatorëve me Llogari të Shumëfishta	26
Kapitulli 3	Pagesa e Faturave.....	26
	Neni 63 : Metoda e Pagesës	26
	Neni 64 : Parapagimet e Detyrueshme.....	27
	Neni 65 : Depozitet për Pajisjet	27
	Neni 66 : Vendi për të Marrur dhe për të bërë Pagesën e Faturës	28
Kapitulli 4	Përkujtuesi i Pagesës dhe Plani i Pagesës	29
	Neni 67 : Lëshimi i Vërejtjes Përkujtuese për Pagesë	29
	Neni 68 : Marrëveshjet për Pagesë.....	30
Kapitulli 5	Përshtatjet dhe Korrigjimet në Faturim.....	30
	Neni 69 : Gabimet e Paqëllimta në Faturim.....	30
	Neni 70 : Mbifaturimi me Paramendim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	30
	Neni 71 : Nënaturimi me Mashtrim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	31
Kapitulli 6	Fatura e Konsumatorëve dhe Historiku i Pagesës	31
	Neni 72 : Ofrimi i Faturave të Kaluara të Konsumatorëve dhe Historiku i Pagesës	31
PJESA 9	FUSHATA PËR INFORMIM PUBLIK.....	31
	Neni 73 : Fushata për Informim Publik e Drejtuar nga Rregullatori	31
	Neni 74 : Fushata për Informim Publik e Drejtuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.....	32
PJESA 10	ZBATIMI DHE DËNIMET	33
Kapitulli 1	Zbatimi nga Rregullatori.....	33
	Neni 75 : Zbatimi	33

Kapitulli 2 Raportet dhe Regjistrimet.....	33
Neni 76 : Regjistrimet dhe Raportet	33
SHTOJCAT.....	35
SHTOJCA 1.....	36
PËRMBAJTJA MINIMALE E KARTËS SË KONSUMATORËVE	36
SHTOJCA 2.....	39
PËRMBAJTJA MINIMALE E KONTRATËS SË SHËRBIMIT	39

PJESA 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kapitulli 1 Fushëveprimi, Qëllimi dhe Definicioni

Neni 1 : Autoriteti për këtë Rregull

Rregullatori nxjerr këtë Rregull nën autoritetin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/49 Mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave i datës 26. Nëntor 2004.

Neni 2 : Fushëveprimi

- 2.1 Të gjithë Ofruesit e Shërbimeve Publike të Grumbullimit së Mbeturinave duhet të lëshojnë Kartën e Konsumatorëve konform kërkesave të kësaj Rregulle për të gjithë Konsumatorët e tanishëm dhe të ardhshëm siç është përcaktuar në Rregull dhe sipas përmirësimeve, plotësimeve dhe/ose zëvendësimeve të bëra nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 2.2 Karta e Konsumatorëve, e cila duhet të përgatitet dhe bazohet konform kësaj Rregulle, duhet të paraqes të drejtat dhe obligimet e Konsumatorëve si dhe të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve Publike të Grumbullimit të Mbeturinave në lidhje me:
 - (a) Aplikimin për Shërbime të Grumbullimit të Mbeturinave;
 - (b) Lidhjes dhe Zbatimit të Kontratës së Shërbimeve;
 - (c) Kërkesën ndaj Konsumatorëve për Parapagim të Detyrueshëm si një garancë e pagesës ndaj Faturave të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve Publike të Grumbullimit të Mbeturinave;
 - (d) Lëshimin e Faturave dhe rregullave për pagesat e Faturave.
 - (e) Menaxhimin e kërkesave dhe dhe ankesave të Konsumatorëve;
- 2.3 Nga Ofruesit e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave kërkohet që të përdorin formatin për Kontratën e Shërbimit ashtu siç është e specifikuar në këtë Rregull dhe të i Faturojnë Konsumatorët sipas procedurave që ipen në këtë Rregull.

Neni 3 : Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulle është të identifikojë dhe të sigurojë të drejtat dhe obligimet reciproke të Konsumatorëve dhe të Ofruesve të Shërbimeve Publike të Grumbullimit të Mbeturinave dhe të prodhojë mekanizma me të cilët ato të drejta dhe obligime reciproke do të mirëmbahen dhe respektohen.

Neni 4 : Definicionet

Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore duhet të përmbajnë kuptimet si në vijim:

“Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave” nënkupton automjetet e shfrytëzuara për Grumbullimin dhe/ose transportimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale;

- “Autoriteti Menaxhues”** nënkupton autoritetin dhe pushtetin e dhënë në marrëveshjen me shkrim që lidhet në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të cilën në mënyrë të veçantë deklarohet se (1) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i dedikuar për atë qëllim në Konsolidim është i autorizuar dhe përgjegjës për mbikqyrjen menaxhuese dhe operuese të cilitdo Ofrues tjetër të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave e operon në Zonën e Shërbimit dhe (2) Ofruesi tjetër i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit do të jetë në pajtim me kërkesat e marrëveshjes në fjalë;
- “Banor”** nënkupton personin e gjallë që jeton brenda Zonës së Shërbimit;
- “Borxhet e Vjetra”** nënkupton të gjitha borxhet e Konsumatorëve lidhur me Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave që janë të evidentuara me Fatura të pakontestueshme të lëshuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave tek ai Konsumator me apo para 31 dhjetor 2002 dhe të cilat nuk janë paguar në tërësi siç është definuar dhe rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;
- “Depoziti për Pajisje”** nënkupton shumën e të hollave të kërkuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nga Konsumatori si siguri financiare ndaj pasurive të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të vendosur në objektet e Konsumatorëve me qëllim të ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Ditë Pune”** nënkupton cilado ditë përveç të shtunës dhe të dielës, festë e paraparë më ligj apo ditë tjetër që është Festë Zyrtare në Kosovë;
- “Fatura”** nënkupton dokumentin me shkrim që dërgohet tek Konsumatori me qëllim të caktuar për të ngarkuar Konsumatorët për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të ofruara ose ndonjë entitet tjetër ligjor që ka të drejtë të bëjë një gjë të tillë dhe me një format dhe përmbajtje që ipet në këtë Rregull;
- “Festë Zyrtare”** nënkupton cilëndo ditë që njifet ose e dedikuar nga autoritetet qeveritare si ditë që nuk punohet;
- “Karta e Konsumatorëve”** nënkupton dokumentin e shkruar që është pregaditur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe që i është vënë në dije secilit Konsumator dhe i cili rradhitë të drejtat dhe obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve që kanë ndaj njëri tjetrit.
- “Komision Shqyrtues”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Komisioni Këshillues i Konsumatorëve”** nënkupton komisionin e themeluar nga Rregullatori konform Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;

- “Komuna”** nënkupton Komunitet lokale të paraqitura në Planin A në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/43 të 27 korrikut 2000 Mbi Numrin, Emrat dhe Kufijtë e Komunave në datën kur kjo Urdhëresë Administrative ka hy në fuqi
- “Konsumator Shtëpiak”** nënkupton Konsumatorin e klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si person i cili shfrytëzon Shërbimet në banesën ose amvisërinë e tij apo saj;
- “Konsumator Institucional”** nënkupton cilindo subjekt ligjor të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si autoritet qeveritar, autoritet lokal, organizatë ndërkombëtare apo institucion i cili kryen veprimtaritë të interesit të përbashkët apo publik dhe i cili nuk është i regjistruar si organizatë afariste në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Mbi Regjistrimin e Organizatave Afariste në Kosovë.
- “Konsumator Komercial-Industrial”** nënkupton cilindo person, subjekt ligjor ose organizatë afariste të klasifikuar nga Ofruesi i Shërbimeve si Konsumator i cili shfrytëzon Shërbimet për apo në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së vet industriale apo komerciale të cilit do lloj;
- “Konsumator”** nënkupton një person, që ka hyrë në Kontratë Shërbimi me një Ofrues të Shërbimeve ose ka marrë shërbime të ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve;
- “Kontejneri për Mbeturina”** nënkupton cilindo lloj të kontejnerëve ose shportat për mbajtjen e Mbeturinave të Ngurta Komunale të grumbulluara para mbledhjes dhe/ose heqjes së tyre;
- “Kontratë e Shërbimit”** nënkupton marrëveshjen me shkrim në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorëve të tij që i referohet Nenit 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 Mbi Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave;
- “Letër Jo-Kundërshtuese”** nënkupton letrën e lëshuar nga Rregullatori që deklaron jo kundërshtim për cilatdo veprime të cilave iu përgjigjet, megjithatë nuk bart vërtetim ose aprovim;
- “Licenca e Shërbimit”** nënkupton Licencën e lëshuar nga Rregullatori konform Rregullës së lëshuar nga Rregullatori, që autorizon Ndërmarrjet në Pronësi Publike ose Private të ofrojnë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave për publikun;
- “Marrëveshja për Pagesë”** nënkupton marrëveshjen në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të Konsumatorëve me qëllim të pagesës së Borxheve të Vjetra dhe siç është e definuar dhe e rregulluar në Rregullën e caktuar mbi Borxhet e Vjetra që lëshohet, ndryshohet dhe/ose plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe;
- “Mbeturina të Ngurta Komunale”** nënkupton Mbeturinat e ngurta jo të rrezikshme të prodhuara nga amvisëritë, burimet komerciale dhe afariste, institucionale dhe Mbeturinat e procesuara industriale që nuk janë të rrezikshme;
- “Objekti i Licensuar për Deponim”** nënkupton objektin i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor dhe ku entiteti operues i objektit është i licensuar nga Rregullatori për të operuar në atë objekt;

- “Ofrues i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave”** nënkupton secilin Person që ofron apo ka për qëllim të ofrojë Shërbim të Grumbullimit së Mbeturinave;
- “Parapagimi i Detyrueshëm”** nënkupton shumën e të hollave që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i kërkon nga Konsumatori për arsye të posaçme që aplikohen ndaj pagesave për Faturat e ardhshme të ngarkuara në Konsumatorin në lidhje me Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave;
- “Person i Cenueshëm”** nënkupton cilindo Konsumator të klasifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale si i varfër dhe skamnor;
- “Plani i Konsolidimit”** nënkupton planin e ristrukturimit të sektorit që është krijuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për konsolidim dhe ristrukturim të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Ujërave të Zeza, dhe të Ofruesve të Shërbimeve të Mbeturinave për Mbeldhjen e Mbeturinave të datës 10 shtator 2002 e ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar kohë pas kohe nga ana e Rregullatorit;
- “Regjistri i Konsumatorëve”** nënkupton regjistrin e krijuar, të ruajtur dhe të mbajtur nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe i cili përmban informacione prkatëse për Konsumatorin siç ipet në hollësi në këtë Rregull;
- “Rregullator”** nënkupton autoritetin përgjegjës për rregullimin ekonomik të Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë nën ligjin e aplikueshëm;
- “Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave Shtëpi-më-Shtëpi”** nënkupton shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave të Ngurta Komunale nga njësitë individuale me nga një familje ose Banesave;
- “Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave”** nënkupton Grumbullimin e Mbeturinave të Ngurta Komunale dhe bartjen e tyre deri te Objekti i Licensuar për Deponim;
- “Standardet e Shërbimit”** nënkupton sa i përket Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, standardet që aplikohen ndaj atij Shërbimi në përputhje me Rregullën e Standardeve të Shërbimit dhe nivelin minimal të standardeve që aplikohen ndaj atij shërbimi të përcaktuara nga Rregullatori në Kushtet e Licencës së Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Tarifat e Shërbimit”** nënkupton çdo vlerë, çmim apo taksë të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në lidhje me dispozitat e shërbimeve të tij ndaj Konsumatorëve të vet;
- “Vendbanim”** nënkupton çdo shtëpi, banesë, vendbanim shumë-bloqesh, ndërtesë banimi, apo ndonjë hapsirë tjetër e përdorur për qëllime banimi;
- “Vendbanim”** nënkupton cilëndo vendndodhje për të cilin janë të kërkuar ose janë ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave;
- “Zona e Shërbimit”** nënkupton, në lidhje me Licensimin e Shërbimit, rajonin apo Komunën brenda së cilës Ofruesi përkatës i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ofrojë shërbimet e veta;

Neni 5 : Rregullat e Interpretimit

Në këtë Rregull:

- (a) Cilatdo fjalë dhe shprehje të përdorura në këtë Rregull, që nuk janë veçanërisht të definuara këtu dhe të cilat mund të jenë të paqarta, duhet të përmbajnë kuptimet siç janë të përcaktuara në aktet ligjore të përmendura në Rregullore që autorizon këtë Rregull ose në cilindo tjetër ligj të aplikueshëm në Kosovë; dhe
- (b) Referencat në Rregull duhet të interpretohen sipas kuptimit të cilësdo Rregulle të lëshuar, të modifikuar, ndryshuar, plotësuar, dhe/ose të zëvendësuar nga Rregullatori kohë pas kohe në pajtim me mandatin që i është dhënë Rregullatorit; dhe
- (c) Njëjësi përfshinë shumësin dhe anasjelltas; dhe
- (d) Fjalët e cilësdo gjini që përdoren në këtë Rregull duhet të përfshijnë cilëndo gjini tjetër; dhe
- (e) Referencat për Pjesët, Kapitujt, dhe Nenet, përveç nëse qëllimisht nuk caktohet ndryshe, janë referenca për Pjesë, Kapituj dhe Nene të kësaj Rregulle.

Kapitulli 2 Aplikueshmëria

Neni 6 : Aplikueshmëria

Të gjithë Ofruesit e tanishëm të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kërkohet që ti përmbahen kësaj Rregulle në mënyrën e të vepruarit jo-diskriminues.

PJESA 2 PARIMET E PËRGJITHSHME

Kapitulli 1 Parimet Elementare

Neni 7 : Mirëbesimi

Të gjitha të drejtat e dhëna nën këtë Rregull dhe të gjitha obligimet e vendosura nën këtë Rregull imponojnë përgjegjësi mbi Konsumatorin dhe Ofruesin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave që të pranojnë këto të drejta dhe obligime reciproke në kuptimin e mirëbesimit, korrektësisë dhe ndershmërisë.

Neni 8 : Njohja nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të njohë dhe të pranojë se të gjithë Konsumatorët e tij duhet të gëzojnë një numër të drejtave si në vijim të kësaj Rregulle dhe duhet të sigurojë se këto të drejta të Konsumatorëve do të respektohen dhe që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk do të veprojë ose sillet në asnjë mënyrë që do të ketë ndikim negativ në këto të drejta të Konsumatorëve në çështjet lidhur me ofrimin e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave.

Neni 9 : Njohja nga Konsumatori

Të gjithë Konsumatorët të cilët marrin Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave nga Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave duhet të njohin dhe të pranojnë se

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të gëzojë një numër të drejtash si në vijim të kësaj Rregulle dhe duhet të sigurojnë se këto të drejta do të respektohen dhe që Konsumatori nuk do të veprojë ose sillet në asnjë mënyrë që do të ketë ndikim negativ në këto të drejta të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në çështjet lidhur me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 10 : Mos-Diskriminimi

Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave nuk duhet të diskriminojë asnjë Konsumator të tanishëm ose potencial dhe duhet të respektojë të drejtat e të gjithë Konsumatorëve të tanishëm dhe potencial ashtu siç janë të vendosura nën këtë Rregull pamvarësisht nga cilatdo karakteristikë racore, etnike, kulturore ose ekonomike ose standardit të jetesës të Konsumatorëve të cilët jetojnë në çfarëdo pjese të Zonës së Shërbimit.

PJESA 3 TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË KONSUMATORËVE

Kapitulli 1 Të drejtat e Konsumatorëve

Neni 11 : E Drejta për të marrë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave

- 11.1 Të gjithë Konsumatorët dhe Banorët kanë të drejtën e pranimin të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, duke siguruar se ato Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave janë teknikisht dhe financiarisht të realizueshme për tu ofruar.
- 11.2 Konsumatori i Amvisërisë i cili është i paaftë fizikisht, duke përfshirë arsyet e emergjencës shëndetësore, të dërgojë Mbeturinën e Ngurta Komunale deri tek lokacioni i përcaktuar në vendin e tij të Banimit nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe kur kjo paaftësi i është bërë në dijeni Ofruesit të Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave, Konsumatori i Amvisërisë ka të drejtë të ketë një lokacion tjetër të siguar nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave pa asnjë shpenzim për Konsumatorin e Amvisërisë.
- 11.3 Konsumatori i Amvisërisë që është i caktuar të pranojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave Shtëpi-për-Shtëpi dhe i cili vendbanimin e ka të atillë që është i pa qasje për paisjet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, atëherë Konsumatori i Amvisërisë ka të drejtën e një lokacioni tjetër që i sigurohet nga Ofruesi i Shërbimeve, pa shpenzime plotësuese për Konsumatorin e Amvisërisë.
- 11.4 Përbrenda kufizimeve të vendosura nën këtë Nen, të gjithë Konsumatorët dhe Banorët kanë të drejtë që në çdo kohë të pranojnë Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave në nivelin minimal të Standardeve të Shërbimit për nga kualiteti, siguria dhe rregullësia ashtu siç të vendoset, përmirësohet, modifikohet dhe/ose të plotësohet nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 12 : E Drejta për t'u Informuar

Secili Konsumator ka të drejtë të informohet për të drejtat dhe obligimet e veta që janë të përcaktuara me këtë Rregull.

Neni 13 : Karta e Konsumatorëve

Secili Konsumator ka të drejtën të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i cili e shërben Zonën e Shërbimeve brenda së cilës ndodhet Konsumatori, Kartën e Konsumatorëve e cila i liston të drejtat dhe obligimet e Konsumatorëve si dhe të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 14 : E Drejta për Qasje në të Dhënat e Konsumatorëve

Secili Konsumator duhet të ketë të drejtën e qasjes dhe të shqyrtimit të informacionit të tij personal, i regjistruar dhe i ruajtur në shënime dhe dosjet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, me qëllim të verifikimit të saktësisë së atij informacioni dhe të korigjimit të cilatdo të dhëna që mund të jenë të pasakta në ato shënime ose të identifikimit të cilësdo informatë specifike të cilat ato shënime i përmbajnë e të cilat si në vijim të nën-Nenit 56.2 janë shprehimisht të ndaluara që të përfshihen në ato shënime.

Neni 15 : Faturimi Transparent

Secili Konsumator ka të drejtën e pranimit të Faturës në intervale të rregullta nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të ofruara e cila duhet të jetë e drejtë, e ligjshme, transparente, në pajtim me këtë Rregull dhe me Tarifat për Shërbime ashtu siç aprovohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 16 : Mbrojtja e të Dhënave Personale të Konsumatorëve dhe Informacioneve të Pronësisë

- 16.1 Secili Konsumator ka të drejtën që të dhënat e veta personale dhe informacionet e pronësisë të vendosura në shënime afariste të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, duke përfshirë, pa kufizime, të dhënat të cilat janë të ruajtura në Regjistrin e Konsumatorëve, të mbahen në mënyrë të besueshme dhe mos të lëshohen ose të shpalojnë tek ndonjë palë e tretë pa aprovimin paraprak nga Rregullatori.
- 16.2 Secili Konsumator ka të drejtën të jetë i informuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave se kërkesa është bërë tek Rregullatori për lëshimin e të dhënave të tij personale dhe informatat e pronësisë si dhe natyrën, përshkrimin dhe llojin e të dhënave dhe informacioneve për të cilat është bërë kërkesa për lëshimin dhe zbulimin e tyre.

Neni 17 : Identifikimi i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Secili Konsumator ka të drejtën të kërkojë nga secili i punësuar ose përfaqësues i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave identifikimin e nevojshëm që demonstroi qartë se i punësuar ose përfaqësuesi i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është i punësuar ose përfaqësues i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe përpos kësaj ka të drejtë që paraprakisht të kërkojë arësyet e kërkesës së qasjes, para se të lejoj qasjen në Vendbanimin e tij ose Objektin si në vijimin e Nenit 23 të mëposhtëm.

Neni 18 : E Drejta e Ankesës

- 18.1 Secili Konsumator ka të drejtën të ankohet për cilatdo fakte ose ngjarje të cilat mund të përbëjnë mospërmbushje, nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të obligimeve të vendosura nën këtë Rregull për sa i përket ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 18.2 Secili Konsumator ka të drejtën që cilëndo ankesë tijën të bërë si në vijim të nën-Nenit 18.1 ta ketë të shqyrtuar dhe të procesuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në mënyrë korrekte dhe në kohë, në pajtim me këtë Rregull dhe me Rregullën mbi Standardet e Shërbimeve për Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Kosovë ashtu siç lëshohen nga Rregullatori dhe që mund të modifikohen kohë pas kohe.

Neni 19 : Gjuha e Komunikimit

- 19.1 Secili Konsumator ka të drejtën që gjatë komunikimit me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, të i drejtohet dhe të merr përgjigjjen qoftë në gjuhën Angleze ose Shqipe ose Serbe në pajtim me preferencën e paraqitur nga Konsumatori.
- 19.2 Kurdo që Konsumatori nuk shpreh ndonjë preferencë specifike për përdorimin e gjuhëve të lartëshënuara, të gjitha komunikatat e drejtuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të bëhen në gjuhën që më së shumti flitet në zonën e Banimit dhe/ose të Vendbanimeve të Konsumatorëve.

Kapitulli 2 Obligimet e Konsumatorëve

Neni 20 : Lidhja e Kontratës së Shërbimit

- 20.1 Nga secili Konsumator duhet të lidhë Kontratën e Shërbimit me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në kohën dhe mënyrën e përcaktuar në këtë Rregull ashtu siç lëshohet, përmirësohet, plotësohet dhe/ose zëvendësohet nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 20.2 Pavarësisht nga obligimi i përcaktuar nën nën-Nenin 20.1 të lartëshënuar, Konsumatori pagesa e të cilit në lidhje me Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave është përfshirë në kompletin e tatimeve ose taksave të vendosura drejtpërdrejt nga Komuna brenda së cilës ndodhet Banesa ose Vendbanimi të cilit i ofrohet shërbimi, nuk do të jetë i obliguar të lidhë Kontratën e Shërbimit me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që ofron Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit të asaj Komune.

Neni 21 : Bashkëpunimi për Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 21.1 Secili Konsumator është i obliguar të bashkëpunojë me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në të gjitha mënyrat e arsyeshme që të lehtësoj ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 21.2 Të gjithë Konsumatorët duhet të bëjnë përpjekje permanente të mënjanojnë ose ndihmojnë në mënjanimin e cilatdo pengesave teknike dhe financiare të cilat zvogëlojnë mundësinë e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të ofroj shërbime kualitative në mënyrë të sigurtë, efikase dhe të shëndetshme për të gjithë.

- 21.3 Konsumatori duhet të informojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kur ai ose ajo është Konsumator i Cenueshëm ose kur Konsumatori është i paaftë.

Neni 22 : Pagesa e Faturave

Secili Konsumator është i detyruar të paguajë të gjitha Faturat e dorëzuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për Shërbimet e ofruara të Grumbullimit të Mbeturinave me kohë siç është e vendosur nën këtë Rregull.

Neni 23 : Qasja në Pronë

Secili Konsumator duhet ti ndihmojë dhe ti lejojë Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave qasjen e arësyeshme në Banesë, Objekte ose prona, gjatë orarit të rregullt të punës, gjatë Ditëve të Punës ose në cilëndo ditë tjetër në rast të emergjencës, për qëllime të:

- (a) Vendosjes dhe/ose shërbimit të Kontejnerëve dhe Mbeturinave të cilatdo lloj;
- (b) Inspektimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve të shfrytëzuara për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave;
- (c) Shpërndarjes së Faturave dhe grumbullimit të pagesave për ato Fatura;
- (d) Bërjes së sondazheve në lidhje me Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave, që kanë të bëjnë me ankesat si dhe drejtimin të çështjeve tjera që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
- (e) Kurdo që me arsye kërkohet qasja në pronat e lartpërmendura të Konsumatorëve për qëllime tjera që lidhen drejtpërdrejt me ofrimin efikas dhe efektiv të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në pajtim me afatet dhe kushtet e paraqitura në Kontratën e Shërbimit, Kartën e Konsumatorëve dhe/ose me cilatdo Rregulla të lëshuara dhe detyruese nga Rregullatori kohë pas kohe të cilat i janë bërë me dijeni Konsumatorëve

Neni 24 : Pagesa e Borxheve të Vjetra

Secili Konsumator është i detyruar të bëjë pagesat dhe/ose të zgjidhë Borxhet e Vjetra dhe të maturuara për Shërbimet e ofruara të Grumbullimit të Mbeturinave në mënyrën e përshkruar në Rregullën mbi Zgjidhjen dhe Faljen e Borxheve të Vjetra ashtu si lëshohet, përmirësohet, plotësohet dhe/ose të zëvendësohet nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 25 : Respektimi i Pasurive të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 25.1 Secili Konsumator gjithmonë duhet të respektojë integritetin dhe gjendjen e mirë të të gjitha asetëve të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilat janë pjesë ose janë të lidhura me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave pavarësisht nëse ato pasuri ndodhen apo nuk ndodhen në pronën e Konsumatorëve.
- 25.2 Secili Konsumator me kujdesin e duhur duhet të shfrytëzojë asetet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave konform të gjitha udhëzimeve të arsyeshme dhe të bazuara të cilat mund të sigurohen nga Ofruesi i Shërbimeve për

Grumbullimin e Mbeturinave kohë pas kohe për Konsumatorët ashtu siç bëhet njoftimi nga Rregullatori.

Neni 26 : Shfrytëzimi Ekskluziv i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Të gjithë Konsumatorët të cilët ndodhen në Zonën e Shërbimit të caktuar janë të obliguar të shfrytëzojnë vetëm shërbimet e Ofruesit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave të licencuar nga Rregullatori për të ofruar Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit në fjalë.

Neni 27 : Ndryshimet në Fakte dhe Rrethana

Secili Konsumator pa vonesë duhet të njoftojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për cilatdo fakte dhe/ose rrethana të cilat janë në gjendje të shkaktojnë ndërprerje ose të kenë ndikim negativ në ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ose të shkaktojnë ndonjë dëmtim në pasuritë e shfrytëzuara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për ofrimin e Shërbimeve të tilla për Grumbullimin e Mbeturinave.

PJESA 4 TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË OFRUESIT TË SHËRBIMEVE PËR GRUMBULLIMIN E MBETURINAVE

Kapitulli 1 Të Drejtat e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Neni 28 : E Drejta e Faturimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

Çdo Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtë në këmbim të ofrimit të dakorduar të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, të Faturojë Konsumatorin në pajtim me Tarifat e Shërbimit në fuqi ashtu siç aprovohen, përmirësohen, modifikohen, plotësohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 29 : E Drejta për të Pranuar Pagesën

Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtën të pranoj pagesën në kohë dhe me përpikëmeri për Faturën e lëshuar tek Konsumatori, të pregaditur në pajtim me Tarifat e Shërbimit ashtu siç aprovohen, përmirësohen, modifikohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 30 : Të Drejtat Lidhur me të Dhënat Personale dhe Informatat Pronësore të Konsumatorëve

Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtë të grumbullojë, mirëmbajë, freskojë me të dhëna të reja, përpunojë dhe të shfrytëzojë të dhënat personale dhe informatat pronësore të Konsumatorëve me qëllim të vetëm ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në pajtim strikt me përcaktimet e Rregullatorit që kanë të bëjnë me këtë aspekt ashtu siç është e paraqitur në këtë Rregull dhe/ose e përcaktuar nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 31 : Ekskluziviteti i Zonës së Shërbimit

Ofruesi i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të veprojë vetëm në Zonën e Shërbimit të definuar në Licencën e Shërbimit, e lëshuar nga Rregullatori në lidhje me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimit përveç nëse në mënyrë specifike thuhet ndryshe për sa i përket saj, në Licencën e tij të Shërbimit.

Neni 32 : Shfrytëzimi i Aseteve të Domenit Publik

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtën e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të asetëve që i takojnë pronësisë publike të cilat shfrytëzohen për dhe/ose në lidhje me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në pajtim me dispozitat dhe kushtet e paraqitura në Licencën e Shërbimit të dhënë nga Rregullatori përkitazi me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Zonën e Shërbimeve.

Neni 33 : Qasja në Godina

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtën e qasjes së arsyeshme në Banesat, Objektet ose Pronat e Konsumatorëve më qëllim të ofrimit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në pajtim me kushtet e paraqitura në nenin 23 të lartëshënuar.

Kapitulli 2 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Neni 34 : Pajtueshmëria me Kushtet e Licencës së Shërbimit

- 34.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet gjithmonë të i'u përmbahet kushteve të Licencës së Shërbimit, që i është lëshuar nga Rregullatori më qëllim të ofrimit të Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 34.2 Ofruesi i Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave gjithnjë duhet të jetë në pajtim më Standardet minimale për Shërbime të kualitetit, sigurisë dhe rregullsisë së shërbimeve siç është e paraparë në Licencën e Shërbimit, Standardet e Shërbimeve, Kartën e Konsumatorëve dhe/ose cilatdo rregulla tjera në fuqi ashtu siç lëshuohen, përmirësohen dhe/ose të zëvendësohen nga Rregullatorit kohë pas kohe.

Neni 35 : Ofrimi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 35.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ofrojë Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave tek të gjithë Konsumatorët dhe Banuesit në Zonën e Shërbimeve të cilët ndodhen përgjatë rrugëve dhe rrugëve automobilistike, rrugëve private dhe zonave të cilat janë të kalueshme për Automjetet për Grumbullimin e Mbeturinave të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të cilat janë të mundëshme të kryhen për sa i përket anës teknike dhe financiare.
- 35.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të jetë në pajtim me kushtet e obligimeve të interesit publik për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nëpër fshatëra dhe zona rurale që ndodhen përbrenda Zonës së Shërbimeve në pajtim me kushtet e Licencës së Shërbimit dhe brenda kufizimeve të dhëna në nenin-Nenin 35.1 të lartëshënuar.

Neni 36 : Faturimi i Konsumatorëve

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të Faturojë Konsumatorët për Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të ofruara vetëm në bazë të Tarifave të Shërbimit në fuqi të llogaritura në pajtim me përcaktimet e Rregullatorit dhe nuk duhet të Faturojë Konsumatorin me çfarëdo shuma tjera të paautorizuara për shërbimet ose të mirat që nuk kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 37 : Veprimtaritë Afariste të Pa-Autorizuara

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të anagazhohet në cilatdo veprimtari tjera të cilat nuk janë të autorizuara në Licencë të Shërbimit, dhe/ose në cilatdo Rregulla tjera në fuqi ashtu siç lëshohen, përmirësohen, plotësohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 38 : Menaxhimi i Ankesave

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pranojë, përgjigjet dhe trajtojë në mënyrë korrekte dhe në kohë ankesat e bëra nga Konsumatori, të mbajë shënime për ato ankesa në pajtim me kërkesat e kësaj Rregulle dhe/ose cilindo Rregull tjerët në fuqi ashtu siç lëshohen, përmirësohen, plotësohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 39 : Ofrimi dhe Shpërndarja e Informatave

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet tu japë informacione Konsumatorëve dhe/ose publikut të gjërë në pajtim me këtë Rregull dhe/ose cilatdo Rregulla tjera ashtu siç lëshohen, përmirësohen, plotësohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 40 : Shfrytëzimi i Aseteve në Pronësi Publike

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithmonë duhet të sigurojë përdorim të kujdeshëm dhe mirëmbajtje të rregulltë të të gjitha asetëve në pronësi publike dhe/ose cilatdo prej asetëve private që i përkasin Shërbimeve për Mbeldhjen e Mbeturinave në pajtim me këtë Rregull dhe kushtet e shkruara në Licencën për Shërbime dhe/ose cilatdo Rregulla tjera në fuqi ashtu siç lëshohen, përmirësohen, plotësohen dhe/ose zëvendësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.

Neni 41 : Obligimet për Informim dhe për Raportim

Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të respektojë obligimet e informimit dhe raportimit konform përshkrimeve në Licencën e tij të Shërbimit, Kartën e Konsumatorëve, dhe ose në cilëndo rregull tjetër ashtu siç lëshohet, përmirësohet, plotësohet dhe/ose zëvendësohet nga Rregullatori kohë pas kohë për të monitoruar përmbushjen e obligimeve të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të përcaktuar në këtë Rregull.

PJESA 5 KARTA E KONSUMATORËVE

Kapitulli 1 Përgatitja dhe Përmbajtja

Neni 42 : Përgatitja e Kartës së Konsumatorëve

- 42.1 Brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulle, secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pregadisë Kartën e Konsumatorëve e cila në minimum duhet të përfshijë përmbajtjet e specifikuar në këtë Rregull.
- 42.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mëpastaj duhet të ketë mundësinë që të shtojë informacione plotësuese dhe të hollësishme në politikat e veta afariste dhe të marrëdhënieve me Konsumatorët.

Neni 43 : Përmbajtja e Kartës së Konsumatorëve

- 43.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pregatisë Kartën e Konsumatorëve, e cila duhet të listoj në mënyrë të qartë të gjitha të drejtat dhe obligimet e Konsumatorëve dhe të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të vendosura me këtë Rregull.
- 43.2 Përmbajtja e Kartës së Konsumatorëve duhet në thelb të bazohet në modelin e Kartës së Konsumatorëve e bashkangjitur si Shtojcë në këtë Rregull, megjithatë Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë mundësinë që të prodhojë Kartën e Konsumatorëve në format tjetër dhe/ose me dizajn grafik të ndryshëm ashtu si gjykohet nga ai, si më e përshtatshme për vete dhe/ose për Konsumatorët e vet.

Neni 44 : Gjuha e Kartës së Konsumatorëve

- 44.1 Karta e Konsumatorëve e pregaditur si në vijim të Nenit 43 duhet të lëshohet dhe të jetë në dispozicion në secilën gjuhë zyrtare që përdoret në Kosovë dhe siç është paraqitur në nën-Nenin 78.1 të mëposhtëshënuar dhe duhet të lëshohet tek Konsumatorët nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në gjuhën që preferohet nga secili Konsumator.
- 44.2 Nëse Konsumatori nuk ka shfaqur ndonjë preferencë për cilëndo gjuhë që përdoret në Kosovë, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të lëshojë Kartën e Konsumatorëve në gjuhën e cila më gjerësisht flitet në zonën gjeografike të Banimit të Konsumatorëve dhe/ose Vendbanimit.

Neni 45 : Shqyrtimi i Kartës së Konsumatorëve nga ana e Rregullatorit

Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dorëzojë tek Rregullatori projekt kopjen e Kartës së vet të Konsumatorëve të propozuar, i cili duhet të përfundojë shqyrtimin lidhur me pajtueshmërinë me këtë Rregull dhe brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës në të cilën Rregullatori ka pranuar projektin në fjalë, Rregullatori ose duhet të kthejë projektin në fjalë ose duhet të lëshojë Letrën Jo-Kundërshtuese tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Kapitulli 2 Lëshimi i Kartës së Konsumatorëve

Neni 46 : Shtypja e Kartës së Konsumatorëve

- 46.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të lëshojë në formë të shtypur dhe gjithmonë të mbajë stoqe të kopjeve të Kartës së vet të Konsumatorëve në një sasi të mjaftueshme për shpërndarje falas nga një kopje për secilin Konsumator, për secilin të punësuar të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe të ketë kopje rezervë në dispozicion për Konsumatorët e ri, si dhe të vazhdojë me shpërndarjen e tyre ashtu siç mund t'a përcaktojë Rregullatori kohë pas kohe.
- 46.2 Me kërkesë të Konsumatorëve për Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, informacionet plotësuese për detajet e plota teknike dhe/ose afariste për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave duhet të jenë në dispozicion falas.

Neni 47 : Shpërndarja e Kartës së Konsumatorëve

- 47.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të shpërndajë kopjet e Kartës së Konsumatorëve në të njëjtën kohë kur të merr nënshkrimin për Kontratën e Shërbimit, brenda kufizimeve të krijuara në Nenin 20 dhe tek të gjithë Konsumatorët të cilët kanë kërkuar kopjet e dokumentit në fjalë dhe/ose kopjen e letres informative që përmban një përmbledhje të shkurtër të karakteristikave kryesore të Kartës së Konsumatorëve ashtu siç Rregullatori mund të i përcaktoj kohë pas kohe.
- 47.2 Përveq kësaj Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të publikojë Kartën e Konsumatorëve tek Konsumatorët e vet dhe/ose publikut të gjërë me mjetet si në vijim kurdoherë që teknikisht dhe ekonomikisht të jetë e realizueshme një gjë e tillë, me vetëiniciativë dhe/ose kurdo që përcaktohet nga Rregullatori kohë pas kohe:
- (a) Nëpërmes të publikimit në faqen e internetit të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe/ose në faqen e Rregullatorit;
 - (b) Shpalljet në gazetatat vendore të Kartës së Konsumatorëve dhe/ose ndryshimet e saj, dhe/ose plotësimet ose shtesat e saj;
 - (c) Shpërndarja e kopjeve të Kartës së Konsumatorëve nëpërmes të librarive publike, zyreve për informim publik, zyret për marrëdhënie me publik të entiteteve publike dhe private ku janë në dispozicion zonat e shpërndarjes publike;
 - (d) Të mbajë në zyret e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave së paku tri kopje të shtypura të Kartës së Konsumatorëve në secilën gjuhë e kërkuara si në vijim të Nenit 44.

Neni 48 : Shpenzimet e Përgatitjes, Shtypjes dhe Shpërndarjes të Kartës së Konsumatorëve

- 48.1 Të gjitha shpenzimet që kanë të bëjnë me përgatitjen, shtypjen dhe shpërndarjen e Kartës së Konsumatorëve duhen të jenë në përgjegjësinë e vetme të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

- 48.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përfshijë të gjitha shpenzimet në lidhje me përgatitjen dhe shpërndarjen e Kartës së Konsumatorëve me qëllime të llogaritjes së Tarifave të Shërbimit.

Kapitulli 3 Modifikimi dhe Ri-lëshimi i Kartës së Konsumatorëve

Neni 49 : Modifikimi i Kartës së Konsumatorëve

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dorëzojë më parë tek Rregullatori për shqyrtim cialtdo ndryshime thelbësore të propozuara për t'u përfshirë në Kartën e vet të Konsumatorëve të cilat duhet të bëhen në pajtim me Nenin 45.

Neni 50 : Lëshimi i Kartës së Modifikuar të Konsumatorëve

Brenda një (1) muaji që nga marrja e Letrës Jo-Kundërshtuese nga Rregullatori, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të lëshojë dhe publikojë tek Konsumatorët dhe për publikun e gjërë Kartën e modifikuar të Konsumatorëve në pajtim me kërkesat e parashtruara për këtë qëllim në këtë Rregull.

Neni 51 : Ri-lëshimi i Kartës së Konsumatorëve

- 51.1 Në rast se nuk ka modifikime në Kartën e Konsumatorëve, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të rilëshojë tek Konsumatorët Kartën e vet të Konsumatorëve çdo dy (2) vite simbas mënyrës që është e paraparë në këtë Rregull dhe siç përcaktohet nga Rregullatori kohë pas kohe dhe duhet të pajisë në të njëjtën kohë me nga një kopje Rregullatorin.
- 51.2 Rilëshimi periodik i Kartës së Konsumatorëve në pajtim me nën-Nenin 51.1 të lartëshënuar, paisja e Konsumatorëve të tij me të si dhe infomacionet e ofruara për publikun në lidhje me Kartën e Konsumatorëve duhet të ndjekin rregullat e njëjtat të paraqitura më lartë për lëshimin dhe modifikimin e Kartës së Konsumatorëve.

PJESA 6 KONTRATA E SHËRBIMIT

Neni 52 : Përmbajtja e Kontratës së Shërbimit

- 52.1 Kontrata e Shërbimit e lidhur në mes të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe Konsumatorëve, si në vijim të Nenit 20 duhet të përfshijë së paku informacionin e kërkuar siç ofrohet në shtojcën e kësaj Rregulle, edhepse Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave lejohet të përfshijë informacione plotësuese dhe/ose marrëveshjet që nuk janë kontradiktore me formën standarde të Kontratës së Shërbimit të përcaktuar në shtojcën në fjalë të kësaj Rregulle.
- 52.1 Kontrata e Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave duhet të i referohet dhe kur është e përshtatshme të përmbledhë dispozitat kyçe të Kartës së Konsumatorëve.

Neni 53 : Shqyrtimi i Rregullatorit të Projekt Kontratës së Shërbimit

- 53.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përgatisë dhe të dorëzojë tek Rregullatori projekt Kontratën e Shërbimit të propozuar të përgatitur kryesisht sipas kushteve të parapara në këtë Rregull brenda një (1) muaji nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.

- 53.2 Brenda njëzet (20) Ditëve të Punës nga data e pranimit të Projekt Kontratës së Shërbimit, Rregullatori duhet të dërgojë tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave:
- (a) Letrën Jo-Kundërshtuese; ose
 - (b) Vendimin se cilat marrëveshje të caktuara të Projekt Kontratës së Shërbimit do të kërkohet që të përmirësohen, për të konfirmuar atë projekt kontratë ndaj dispozitave të kësaj Rregulle dhe/ose për karakteristikat kryesore të Kontratës së Shërbimit si në vijim të formës standarde që gjendet në shtojcën e kësaj Rregulle.
- 53.3 Në rastin e paraparë në nën-Nenin 53.2(b) të lartëshënuar, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të përfshijë ndryshimet në Projekt Kontratën e Shërbimit siç përcaktohet nga Rregullatori dhe të ridorëzojë atë Projekt tek Rregullatori brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës.
- 53.3 53.4 Pas marrjes së Letrës Jo Kundërshtuese nga Rregullatori, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të finalizojë Kontratën e Shërbimit dhe duhet të iniciojë procesin e lidhjes së asaj kontrate me të gjithë Konsumatorët brenda kufizimeve të paraqitura në Nenin 20 të lartëshënuar, brenda katër (4) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.

Neni 54 : Modifikimi i Kontratës së Shërbimit

- 54.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave tek Rregullatori në çdo kohë mund të dorëzojë cilatdo ndryshime thelbësore të cilat ai i propozon në Kontratën e tyre të Shërbimit dhe Rregullatori duhet t'i shqyrtojë ato ndryshime të propozuara për atë kontratë në pajtim me Nenin 45 të lartëshënuar.
- 54.1 Cilado modifikime në Kontratën e Shërbimit duhet të lidhen nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave me të gjithë Konsumatorët e tyre në pajtim me rregullat e përcaktuara në Nenin 43 të lartëshënuar.

PJESA 7 REGJISTRI I KONSUMATORËVE

Kapitulli 1 Regjistri i Konsumatorëve

Neni 55 : Regjistrimi i Konsumatorëve

- 55.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të organizojë dhe mbajë Regjistrin e Konsumatorëve me të cilët ka lidhë Kontratë të Shërbimit si në Nenin 20 të kësaj Rregulle, i cili duhet të jetë në dispozicion të Konsumatorëve për të verifikuar përfshirjen e tyre në ato shënime si dhe saktësinë dhe kompletueshmërinë e të dhënave të tyre individuale të Konsumatorëve në këto shënime.
- 55.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pregadisë me shkrim procedurat e duhura për Konsumatorët të cilët dëshirojnë të inspektojnë dosjet e tyre individuale të Konsumatorëve në Regjistrin e Konsumatorëve dhe të dërgojnë kopjen e udhëzimeve në fjalë tek Rregullatori i cili periodikisht duhet të bëjë inspektimin për të siguruar përmbushjen e tyre.

- 55.2 Të gjithë Konsumatorët duhet të kenë të drejtën që të korrigjojnë cilatdo gabime faktike dhe/ose të freskojnë me të dhëna të reja dosjet e tyre personale të arkivuara në Regjistrin e Konsumatorëve.

Neni 56 : Përmbajtja e Regjistrit të Konsumatorëve

- 56.1 Shënimet që duhet të arkivohen në Regjistrin e Konsumatorëve së paku duhet të përfshijnë informatat dhe të dhënat përkatëse si në vijim:
- (a) Numrin identifikues që është specifik për një Konsumator të vetëm. Numri identifikues asnjëherë nuk duhet të shfrytëzohet përsëri nëse Konsumatori përfundon të jetë më Konsumator për çfarëdo arsye; dhe
 - (b) Numrin e llogarisë që është specifik për secilin vend ose vendndodhje në të cilën ofrohet shërbimi; dhe
 - (c) Emrin e plotë dhe adresën e Konsumatorëve ku duhet të dërgohen Faturat ose në të cilën Konsumatori dëshiron t'i pranojë ato; dhe
 - (d) Adresën e plotë të Konsumatorëve në të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ofron Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
 - (e) Të dhënën për statusin e Konsumatorëve nëse ai është pronar, qiraxhi ose agjent i pronës ose vendndodhjes në të cilën do të pranoj shërbimet; dhe
 - (f) Të dhënën për kategorinë e Konsumatorëve e shprehur si Amvisëri, ose Komercial/Industrial ose Institucional; dhe
 - (g) Përshkrimin e shkurtër për llojin dhe mënyrën në të cilën ofrohen Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
 - (h) Datën në të cilën është nënshkruar Kontrata e Shërbimit si në Nenin 20; dhe
 - (i) Tarifat e aplikueshme të Shërbimeve për llojin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të ofruara; dhe
 - (j) Hollësitë e Kontratës së Shërbimit, nëse janë të zbatueshme, të nënshkuara me Konsumatorin duke përfshirë datën e nënshkrimit dhe datën e hyrjes në fuqi; dhe
 - (k) Hollësitë e cilësdo Kontratë për Borxhet e Vjetra dhe Aranzhimin e Pagesës të lidhur me Konsumatorin;
 - (l) Llogaria aktuale e Konsumatorëve që vërteton të gjitha të dhënat përkatëse relevante të Konsumatorëve për të gjitha Faturat e lëshuara si dhe gjendjen e pagesës së tyre për një periudhë që mbulon në minimum njëzetekatër (24) muaj; dhe
 - (m) Një shënim, nëse është i zbatueshëm që vërteton se Konsumatori është Person i Cenueshëm; dhe
 - (n) Cilatdo të dhëna tjera të dëshiruara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për veprimtarinë e tij më efektive dhe të cilat kan të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

- 56.2 Është rreptësisht e ndaluar të ruhen në Regjistrin e Konsumatorëve cilatdo të dhëna si në vijim:
- (a) Përkatësia religjioze e Konsumatorëve;
 - (b) Etnia e Konsumatorëve;
 - (c) Gjinia e Konsumatorëve;
 - (d) Përkatësia politike e Konsumatorëve;
 - (e) Përkatësina e Konsumatorëve në cilatdo shoqata, grupe shoqërore, ose organizata të cilitdo lloj; dhe
 - (f) Cilatdo të dhëna tjera të Konsumatorëve që nuk kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ose cilatdo të dhëna të cilat janë të ndaluara nën cilindo ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë.
- 56.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të largojë menjëherë nga Regjistri i Konsumatorëve cilatdo të dhëna të ndaluara dhe/ose cilatdo të dhëna personale të Konsumatorëve të cilat konsiderohen jo të dispozueshme që të ruhen dhe/ose shfrytëzohen pas cilësdo:
- (a) Rregulle të Rregullatorit;
 - (b) Rregulle të lëshuar nga cilido autoritet tjetër publik kompetent i Kosovës;
 - (c) Rregullave të lëshuara nga cilido gjyq me pushtet kompetent në Kosovë;
 - (d) Rekomandim të lëshuar nga Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës që vërtetohet nga Rregullatori.

Neni 57 : Formati i Shënimeve në Regjistrin e Konsumatorëve

- 57.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbajë shënimet në letër, dhe në kompjuter.
- 57.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i cili ka Autoritet Menaxhues mbi Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në funksion të plotësisht të shënimeve të veta, si në vijim të nën-Nenit 55.1 të lartëshënuar, duhet të mbajë dhe përshijë të gjithë Konsumatorët që pranojnë shërbime nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nën Autoritetin Menaxhues në fjalë.
- 57.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave i cili ka Autoritet Menaxhues mbi Ofruesit e tjerë për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu duhet të mbajë verzionin elektronik të atyre shënimeve duke shfrytëzuar softverin kompjuterik që aprovohet nga Bordi i tij Mbikqyrës.

Kapitulli 2 Siguria e të Dhënave të Ruajtura në Regjistrin e Konsumatorëve

Neni 58 : Siguria dhe Mbrojtja e të Dhënave të Konsumatorëve

- 58.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të mbrojë të dhënat personale të gjithë Konsumatorëve të listuara në Regjistrin e Konsumatorëve dhe nuk duhet të lëshojë, shes, tregtojë, informojë ose tregojë cilatdo të dhëna ose pjesë të tyre tek cilado palë e tretë për çfarëdo qoftë arsye pa aprovimin paraprak nga

Rregullatori në pajtim me cilatdo rregulla të lëshuara nga Rregullatori kohë pas kohe në lidhje me këtë çështje.

- 58.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu duhet të:
- (a) Sigurojë të dhënat e ruajtura në Regjistrin e Konsumatorëve duke përdorur paisje mbrojtëse, metoda, sisteme dhe politika adekuate për mbrotje siç janë pasvordet, nivelet e sigurisë të qasjes, alarme ndërhyrëse, dhe mjete tjera të përshtatshme duke përfshirë shkurtime të rrepta në numrin e të punësuarve të autorizuar të cilët kanë qasje në Regjistrin e Konsumatorëve
 - (b) Përmbahet nga shfrytëzimi i të dhënave të Konsumatorëve për cilatdo qëllime tjera përveç atyre që strikt ose drejtpërdrejt janë të lidhura me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave; dhe
 - (c) Përmbahet nga dhënia e të drejtës së qasjes në Regjistrin e Konsumatorëve cilësdo palë të tretë përveç Rregullatorit, autoriteteve tjera publike të cilat shprehimisht janë të autorizuar të kenë qasje në Regjistrin e Konsumatorëve në pajtim me cilindo ligj të aplikueshëm në Kosovë dhe entiteteve tjera që marrin miratimin e mandatit efektiv në Regjistrin e Konsumatorëve të lëshuar nga cilindo gjyq me pushtet kompetent në Kosovë.

PJESA 8 FATURAT PËR SHËRBIMET E GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE

Kapitulli 1 Fatura e Konsumatorëve – të Përgjithshme

Neni 59 : Fatura e Konsumatorëve – të Përgjithshme

- 59.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pajis me Faturë të gjithë Konsumatorët e vet të cilët kanë pranuar shërbime gjatë periudhës që mbulohet nga Fatura ose të cilët kanë borxh në llogaritë e arkëtueshme në regjistrimet e kontabilitetit.
- 59.2 Fatura duhet të i referohet shumave të maturuara dhe të pagueshme nga Konsumatori vetëm në lidhje me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 59.3 Shpeshësia me të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dërgon Faturat si në vijim të nën-Nenit 59.1 të lartëshënuar nuk duhet të tejkalojë një herë për një muaj kalendarik dhe nuk duhet të jetë më pak se dy herë për periudhat prej dy muajve kalendarik.

Neni 60 : Gjuha dhe Shpërndarja e Faturës

- 60.1 Të gjitha Faturat duhet të jenë ose në gjuhën Shqipe ose në gjuhën Serbe në pajtim me preferencat e shfaqura nga secili Konsumator. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu duhet të ketë mundësinë për të pregaditur Faturat në atë mënyrë që të gjitha informacionet dhe të dhënat në Faturë do të jenë të treguara në mënyrë të njëkohëshme në të tri gjuhët në model dhe madhësi të shtypjes të njëjtë.
- 60.2 Në vijim të nën-Nenit 60.1 të lartëshënuar, nëse Konsumatori nuk shfaq preferencë gjuhësore, ose përderisa ajo preferencë të i komunikohet Ofruesit të Shërbimeve për

Grumbullimin e Mbeturinave, Fatura që do të i lëshohet Konsumatorëve duhet të jetë në gjuhën e cila flitet nga shumica në secilën zonë gjeografike përkatëse ose fshatëra apo brenda secilës Zonë të dhënë të Shërbimit.

- 60.3 Të gjitha Faturat duhet të jenë në format të shtypur dhe duhet të dërgohen personalisht ose me postë (nëse është funksionale ose nëse është e besueshme për një gjë të tillë) në adresën e Konsumatorëve që është e shënuar në Faturë.

Neni 61 : Përmbajtja e Faturës së Konsumatorëve

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është i obliguar të përfshijë dhe të tregojë në mënyrë të qartë dhe ndaras informacionin në vijim në secilën Faturë për qdonjërin dhe për të gjithë Konsumatorët:

- (a) Detajet e kontaktit të Konsumatorëve;
- (b) Numrin identifikues të Konsumatorëve;
- (c) Numrin e llogarisë së Konsumatorëve;
- (d) Numrin e Faturës i cili duhet të jetë unik për një Faturë dhe ose duhet të jetë i shtypur në Faturë ose duhet të prodhohet në mënyrë kompjuterike nëpërmes softverit të Faturimit që shfrytëzohet nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- (e) Data e Faturës dhe periudha kohore e cila mbulohet nga Fatura e shprehur me datën e fillimit dhe datën e mbarimit;
- (f) Kategoria e shërbimit të Konsumatorëve (Amvisëri ose Komerciale/Industriale ose Institucionale)
- (g) Adresa e pronës ose lokacionit ku janë ofruar Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave;
- (h) Shumën e cila kërkohet të paguhet nga Konsumatori e listuar në pajtim me secilën pikë të rradhitur dhe të bashkangjitur në mënyrë që të formoi totalin e kërkuar nga Konsumatori për t'u paguar;
- (i) Data në të cilën Konsumatori i detyrohet shumës totale të borxhit që tregohet në Faturë;
- (j) Kushtet e pagesës dhe informacioni në lidhje me ndihmën e cila mund të jetë në dispozicion dhe procedurat për t'u ndjekur nëse Konsumatori është duke kaluar nëpër vështirësi financiare të atilla që koha e pagesës në tërësi mund të mos realizohet sipas afateve të pagesës;
- (k) Lloji i shërbimit, shpeshtësia e shërbimit, madhësia dhe lloji i kontejnerëve nëse është e zbatueshme si dhe numri i kontejnerëve;
- (l) Tarifa e Shërbimit e aplikueshme për Konsumatorët;
- (m) Cilatdo ngarkesa fikse siç janë marrja ose dhënia me qira e Kontejnerëve të Mbeturinave ose e pasurive tjera të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të shfrytëzuar në ofrimin e shërbimeve
- (n) Shumë e Faturës paraprake që mbulon periudhën që i paraprinë menjëherë periudhës për të cilën Fatura aktuale është pregaditur;

- (o) Cilatdo debi të papaguara ose bilancet kreditore në llogarinë e Konsumatorëve;
- (p) Cilatdo pagesa të bëra në llogarinë e Konsumatorëve që nga koha kur është dërguar Fatura paraprake;
- (q) Shuma e Parapagimit të Detyrueshëm të bërë dhe mbetja e bilancit;
- (r) Shuma e cilitdo Depoziti të Garancës si dhe data në të cilën ai depozit duhet të kthehet tek Konsumatori pa kamatë;
- (s) Numri i telefonit për pyetjet që kanë të bëjnë me Faturën;
- (t) Cilatdo ngarkesa tjera që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave të ofruara, qoftë me kërkesën e Konsumatorëve, ose për shkak të kryerjes së obligimit të Konsumatorëve siç janë gjordat për pagesa të vonuara, shumat që kanë të bëjnë me Aranzhimin e Pagesës ose taksa tjera të aprovuara nga Rregullatori;
- (u) Të gjitha ngarkesat tjera të cilat shkaktojnë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar duhet të tregohen si pikë e veçantë si dhe totali i Tatimit mbi Vlerën e Shtuar i maturuar nga Konsumatori duhet të shënohen si pikë e ndarë.

Kapitulli 2 Faturat për Llogaritë e Shumëfishta

Neni 62 : Faturimi i Konsumatorëve me Llogari të Shumëfishta

- 62.1 Kurdoherë që Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave përgaditë Faturën për një Konsumator që ka një numër të vetëm identifikues dhe numra me llogari të shumëfishtë, Fatura duhet të përfshijë një faqe përmbledhëse që rradhitë secilin numër të llogarisë, emrin e llogarisë, shumën e caktuar për t'u paguar për secilën llogari dhe shumën totale të caktuar nga Konsumatori për të gjitha llogaritë.
- 62.2 Kurdoherë që pagesa pranohet nga Konsumatori për Faturat të cilat si në vijim të nën-Nenit 62.1 të lartëshënuar përfshijnë numra të llogarive të shumëfishta, pagesa duhet të alokohet në mënyrë të njëjtë sikurse secila pagesë të bëhet në faqen përmbledhëse duke filluar nga e para që është e rradhitur përveç nëse qartazi ndryshe tregohet nga Konsumatori.
- 62.3 Në rast se pagesa e bërë nga Konsumatori me llogari të shumëfishta nuk barazohet me shumën totale të maturuar, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të alokojë pagesat në mënyrë proporcionale mbi të gjitha llogaritë e rradhitura. Në këso situatë alokimi i pagesave duhet të bëhet sipas dispozitave të vendosura në nën-Nenin 62.2 të lartë shënuar.

Kapitulli 3 Pagesa e Faturave

Neni 63 : Metoda e Pagesës

Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë me shkrim Konsumatorët e vet për metodat e aplikueshme për pagesën e Faturave. Kjo informatë duhet të duket qartë në secilën Faturë.

Neni 64 : Parapagimet e Detyrueshme

- 64.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjatë kohës së lidhjes së Kontratës së Shëbimit me Konsumatorin ose në kohën e regjistrimit ose në cilëndo kohë më pas, ka të drejtë që të kërkojë Parapagim të Detyrueshëm për arsye të justifikueshme duke përfshirë:
- (a) Konsumatori ka historikun që nuk i ka bërë pagesat e tija me kohë për shërbimet publike; dhe/ose
 - (b) Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka arsye të forta të besojë se Konsumatori mund të braktisë Kosovën përgjithmonë ose për një periudhë kohore e cila do të ndikonte negativisht në mundësinë e tij për të bërë pagesat me kohë; dhe/ose
 - (c) Aryet tjera që konsiderohen si të bazuara.
- 64.2 Të gjitha Parapagimet e Detyrueshme mund të debitohen nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për qëllim të pagesës së cilësdo Faturë për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave të cilat janë të maturuara dhe të pagueshme kurdoherë që Konsumatori ka dështuar të paguajë ato Fatura në datën e maturuar përkatëse.
- 64.3 Maksimumi i shumës së Parapagimit të Detyrueshëm për të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Mbldhjen e Mbeturinave e ka të drejtën nuk duhet të tejkalojë totalin e pritur për dymbëdhjetë (12) muaj të njëpasnjëshëm.
- 64.4 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk është i obliguar të paguajë asnjë kamatë për Parapagimet e Detyrueshme më të vogla se (500) euro.

Neni 65 : Depozitet për Pajisjet

- 65.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtë të kërkojë Depozit për Paisje në çdo kohë kur ai len pranë ose në objektet apo pronat që pranojnë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave cilatdo pasuri të cilat janë në pronësi të tij duke përfshirë maqinerinë ose çfarëdo Kontejnerë të Mbeturinave.
- 65.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kanë të drejtë të kërkojnë Depozit për Paisje vetëm nga Konsumatorët për qëllim të vetëm sigurimin e mbulesës së vlerës së pasurive që referohen në nën-Nenin 65.1 të lartëshnuar.
- 65.3 Vlera e Depozitit për Paisje për të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka të drejtën të bëjë kërkesën nga Konsumatorët nuk duhet të tejkalojë vlerën fer të tregut të zëvendësimit të pasurisë dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojë pesëqind (500) euro.
- 65.4 Në rast se kurdoherë bilanci i depoziteve nuk do të mbulojë shumën e dëmeve të shkaktuara ndaj pasurive, duke përfshirë vjedhjen në tërësi apo të pjesëshme nga një entitet përjashta Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë kompensim përmes negociatave apo nëse ato negociata dështojnë, përmes sistemit legal kompetent dhe Gjykatave të Kosovës.
- 65.5 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të mbajë Depozitin për Paisje për një periudhë kohore që nuk tejkalon afatin e skadimit

të Kontratës së Shërbimit që është në fuqi në mes të Konsumatorëve dhe Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ose deri më datën në të cilën Kontrata për Shërbime në fjalë është ndërprerë.

- 65.6 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas ditës së fundit në të cilën ka të drejtën e mbajtjes së Depozitit për paisjet, duhet ta kthejë atë tek Konsumatori, duke siguruar se Shërbimi për Grumbullimin e Mbeturinave nuk ka ndonjë pretendim ndaj depozitit në fjalë. Në rast se ekziton ndonjë pretendim, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të mbajë shumën e plotë ose cilëndo pjesë të saj të Depozitit për Paisje si në vijim të kompensimit të dhënë në nën-Nenin 65.3 të lartëshënuar.
- 65.7 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk duhet të jetë i obliguar të paguajë qfarëdo kamate të Depozitit për Paisjet bilanci i të cilave është më pak se pesëqind (500) euro.

Neni 66 : Vendi për të Marrur dhe për të bërë Pagesën e Faturës

- 66.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të bëjë vendosjen e vendeve për pagesa në lokacionet duke përfshirë cilatdo zyre afariste të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave si dhe cilatdo vende tjera të përshtatshme të vendosura që i konvenojnë edhe Konsumatorëve edhe Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të cilat duhet të jenë të hapura gjatë orarit të rregullt të punës dhe gjatë të gjitha Ditëve të Punës.
- 66.2 Pas aprovimit nga Rregullatori, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të informojë Konsumatorin për lokacionet e vendeve për pagesa të cilat mund të gjenden në Zonën e Shërbimit brenda së cilës është vendosur lokacioni për marrjen e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 66.3 Në vijim të nën-Nenit 66.2 të lartëshënuar, informata të cilën Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ia sigurojë Konsumatorëve duhet të përfshijë hartën e cila qartazi e identifikon lokacionin e vendit të pagesës, adresën, orarin si dhe ditët e punës kur secili prej atyre vendeve të pagesës është i hapur. Informatat në fjalë duhet të shpërndahen tek Konsumatorët me metodat që janë të ofruara në nën-Nenin 47.1 të lartëshënuar.
- 66.4 Konsumatori duhet të ketë mundësinë për të zgjedhur vendin për pagesë që është më i përshtatshëm për nevojat e veta dhe duhet të informojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave se cilin vend për pagesë e ka zgjedhur. Dështimi për të bërë një gjë të tillë nga Konsumatori duhet të i jep të drejtën Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të identifikojë vet vendin e pagesës.
- 66.5 Konsumatori duhet të ketë të drejtë që cilado Faturë e Shërbimeve të Grumbullimit të Mbeturinave të i dërgohet në Banesën e tij ose vendin e punës nëse sigurohet se ato janë të vendosura në Zonën e Shërbimit që shërbehet nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që e inicon atë Faturë.
- 66.6 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të vendosë një taksë nominale të arsyeshme për dërgesën e cilësdo Faturë tek lokacioni apo vendi që graviton jashtë Zonës së Shërbimeve, përveç nëse ajo dërgesë bëhet përmes postës.

Kapitulli 4 Përkujtuesi i Pagesës dhe Plani i Pagesës

Neni 67 : Lëshimi i Vërejtjes Përkujtuese për Pagesë

- 67.1 Në rast të vonesës ose mungesës së pagesës së cilësdo Faturë që është për t'u paguar, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dërgojë tek Konsumatori përkujtuesin për vonesë të pagesës në mënyrat si në vijim:
- (a) Përkujtuesi i parë duhet të informojë Konsumatorin për numrin e Faturës së papaguar, shumën që duhet të paguhet dhe të sigurojë njoftimin se pagesa duhet të bëhet brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas së cilës Konsumatori do të jetë i detyrueshëm të paguajë dënimin si në vijim:
 - (i) Konsumatorët e Amvisërisë duhet të paguajnë dënimin prej një (1) euro në ditë, që do të aplikohet deri në ditën në të cilën është bërë pagesa për Faturën që duhet për t'u paguar;
 - (ii) Të gjitha kategoritë tjera të Konsumatorëve duhet të paguajnë dënimin prej tre (3) eurove në ditë, e aplikueshme deri në ditën në të cilën bëhet pagesa e Faturës;
 - (b) Shuma e dënimit, sipas aplikimit si në vijim të nën-Nenit 67 (a) të lartëshënuar duhet të dërgohet nga Konsumatori për Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në të njëjtën kohë kur të bëhet pagesa për Faturën që është e caktuar për t'u paguar. Në rast se Konsumatori dështon të bëjë një gjë të tillë, dënimi ditor duhet të rritet për pesëdhjetë përqind (50%).
 - (c) Përveç kësaj edhe adresën e vendit ku mund të bëhet pagesa si dhe numri i telefonit për Konsumatorin që të mundë të thërrasë dhe të informojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave se pagesa është e gatshme si dhe ku dhe kur mund të bëhet.
- 67.2 Nëse pas periudhës prej tridhjetë (30) Ditëve të Punës Konsumatori nuk ka bërë pagesën e kërkuar, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të ketë të drejtë të lëshojë një vërejtje tjetër për pagesë, dhe në vazhdim çdo tridhjetë (30) Ditë të Punës nga një vërejtje tjetër përderisa të bëhet pagesa si dhe të vazhdojë me vendosjen e dënimit siç është dhënë në nën-Nenin 67.1 (a) të lartëshënuar.
- 67.3 Përkujtuesi i pagesës i lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave si në vijim të nën-Nenit 67.1 duhet të ofrojë përpos lokacionit ku mund të bëhet pagesa, edhe numrin e telefonit ku Konsumatori mund të kontaktojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për ta informuar atë se pagesa është gati.
- 67.4 Konsumatori duhet të ketë të drejtën të kërkojë nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të merr pagesën e Faturës qoftë në vendin e Banimit ose vendin e punës së Konsumatorëve, duke siguruar se ai lokacion është përbrenda Zonës së Shërbimit. Nëse nuk është rasti, atëherë duhet të bie barra mbi Konsumatorin që të bëjë pagesën në njërën prej vendeve të pagesës të vendosura në Zonën e Shërbimit në fjalë.
- 67.5 Vërejtjet përkujtuese për pagesë duhet të lëshohen në pajtim me këtë Nen dhe duhet të bëhen me shkrim në të njëjtën gjuhë që përdoret për faturimin e Konsumatorëve dhe duhet të dërgohen tek Konsumatori nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 68 : Marrëveshjet për Pagesë

Konsumatori që nuk është në gjendje të paguajë një ose një numër të caktuar të Faturave të maturuara, ka të drejtë të bëjë kërkesën tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për të bërë pagesën nëpërmes të Marrëveshjes për Pagesë nën kushtet sa vijojnë:

- (a) Kushtet e Marrëveshjes për Pagesë duhet ti mundësojnë Konsumatorit të paguajë Faturat në fjalë si dhe taksën e aplikueshme të kamatës për pagesë të vonuar në këste të barabarta mujore përgjatë një periudhë kohore që nuk tejkalon dymbëdhjetë (12) muaj;
- (b) Konsumatori ka të drejtë të vendosë shumën për pagesë mujore, duke siguruar se është së paku një e dymbëdhjeta (1/12) e shumës totale të përfshirë në Marrëveshjen për Pagesë;
- (c) Veç shumës mujore që duhet të paguhet nën Marrëveshjen për Pagesë, Konsumatori gjithmonë duhet të jetë i detyruar të paguajë të gjitha Faturat aktuale kur ato bëhen të maturuara; dhe
- (d) Nga Konsumatori kërkohet të bëjë pagesën e parë në shumën që është miratuar brenda dy (2) Ditëve të Punës pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Pagesë.

Kapitulli 5 Përshatjet dhe Korrigjimet në Faturim

Neni 69 : Gabimet e Paqëllimta në Faturim

- 69.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të rregullojë Faturën në të cilën Konsumatori është ngarkuar më pak ose më shumë si rezultat i Tarifave të Shërbimit të zbatuara jo si duhet, ose për shkak të gabimit njerëzor.
- 69.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të korrigjojë gabimet në faturim duke vendosur kredi ose debi sipas rastit në llogarinë e Konsumatorëve për shumën e barabartë me gabimin e bërë brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës në të cilën është zbuluar gabimi ose në rast të kontestimit me Konsumatorin, jo më vonë se njëzet (20) Ditë të Punës pas datës në të cilën është zgjidhur kontesti.

Neni 70 : Mbifaturimi me Paramendim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 70.1 Në rast se është vërtetuar se Ofruesi i Shërbimeve për Mbedhjen e Mbeturinave ka mbingarkuar me paramendim Konsumatorin, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në llogarinë e Konsumatorëve që i është bërë e padrejta duhet të kreditoj shumën që është e barabartë me dyfishin e shumës totale e cila është mbingarkuar.
- 70.2 Veç kësaj, Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave që me paramendim e ka mbingarkuar Konsumatorin duhet të paguajë kamatën e barasvlershme me pesëmbëdhjetë përqind (15%) të shumës që është mbingarkuar nëse shuma që paguhet nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave nuk është e kredituar në llogarinë e Konsumatorëve brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës në të cilën është konstatuar se Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka bërë gabimin.

Neni 71 : Nënfaqurimi me Mashtrim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

Në rast se Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka nënfaquruar Konsumatorin si pasojë e mashtrimit dhe/ose ka bërë shpërdorim me paramendim në pjesën e Konsumatorëve duke vepruar vet ose në bashkëpunim me ndonjë të punësuar tjetër të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, brenda njëzet (20) Ditëve të Punës pas datës në të cilën Konsumatori është konstatuar të mbahet përgjegjës për atë veprim Konsumatori duhet të dërgojë shumën e plotë të nën-faturuar tek Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Kapitulli 6 Fatura e Konsumatorëve dhe Historiku i Pagesës

Neni 72 : Ofrimi i Faturave të Kaluara të Konsumatorëve dhe Historiku i Pagesës

- 72.1 Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave, në kërkesë të njërit nga Konsumatorët e tij, duhet të ofrojë informacionin në lidhje me Faturat e kaluara si dhe historikun e pagesës së Konsumatorëve që e bën kërkesën në të njëjtën gjuhë e cila përdoret nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në Faturat e dërguara tek Konsumatori për ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 72.2 Informacioni minimal i cili duhet ofruar nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në përgjigje të kërkesës së parashtruar duhet të jetë në formatin e qartë dhe të kuptueshëm dhe duhet të ofroj:
- (a) Tregues të qartë për muajt dhe vitet për të cilat janë ofruar të dhënat; dhe
 - (b) Periudha për të cilën janë ofruar të dhënat duhet të mbulojë periudhën prej së paku dymbëdhjetë (12) muaj të njëpasnjëshëm, përveç nëse kërkohet ndryshe nga Konsumatori ose nëse Konsumatori ka pranuar Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave më pak se dymbëdhjetë muaj nga data në të cilën është bërë kërkesa; dhe
 - (c) Tregues të qartë për secilin numër të Faturës, shumën totale të Faturës, datën si dhe periudhën të cilën e mbulon Fatura; dhe
 - (d) Tregues të qartë për pagesat e bëra nga Konsumatori për secilën Faturë dhe datën në të cilën janë bërë ato pagesa.
- 72.3 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të vendos taksën për ofrimin e Faturave të kaluara dhe historikun e pagesës për një shumë që mbulon por që nuk tejkalon shpenzimet administrative që janë shkaktuar në mënyrë të arsyeshme për përgatitjen e atyre Faturave dhe historikut të pagesës.

PJESA 9 FUSHATA PËR INFORMIM PUBLIK

Neni 73 : Fushata për Informim Publik e Drejtuar nga Rregullatori

- 73.1 Rregullatori duhet të organizojë dhe të drejtojë fushatën për informim publik në çdo kohë përbrenda periudhës prej tridhjetë (30) deri njëqindetëdhjetë (180) ditëve pas datës kur kjo Rregull hyn në fuqi dhe qëllimi i së cilës është të informojë publikun lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë Rregull, Kartën e Konsumatorëve, Kontratën e Shërbimit, si dhe cilatdo informacione tjera përkatëse.

- 73.2 Rregullatori duhet të informojë të gjithë Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në lidhje me qëllimin e lejimit të tyre të marrin pjesë në fushatën për informim publik si dhe të kërkojnë dhe/ose të marrin parasysh cilatdo kontribute dhe sugjerime të ofruara nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

Neni 74 : Fushata për Informim Publik e Drejtuar nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 74.1 Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të publikoj çështjen e Kartës së vet të Konsumatorëve dhe të shpallë datën në të cilën do të inicioj procesin e nënshkrimit të Kontratave të Shërbimit me Konsumatorët brenda Zonës së Shërbimit.
- 74.2 Të gjitha materialet dhe informacionet e përdorura në cilëndo fushatë të informimit publik të drejtuar nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet:
- (a) Të përmbajnë ose paraqesin informata të sakta, me të dhënat e fundit, të plota dhe jo ç'orientuese;
 - (b) Të mos përzihen me cilatdo reklama komerciale të bëra nga Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për çfarëdo qëllime tjera përveç nëse është përcaktuar ose aprovuar paraprakisht ndryshe nga Rregullatori;
 - (c) Të përdoret gjuha që ka mundësi qasjeje dhe që është e kuptueshme për publikun gjithpërfshirës pa ndonjë kualifikim të veçantë teknik ose prapavijë;
 - (d) Të bëhen në gjuhën ose gjuhët që fliten më së shumti në secilin regjion gjeografik të mbuluar me fushatën e informimit publik brenda Zonës së Shërbimit;
 - (e) Të mos bëhen referenca të qfarëdo lloji, qofshin ato politike, racore, etnike, gjinore, seksuale, morale dhe/ose fetare;
 - (f) T'i shmangen krahasimeve ndërmjet kualitetit të Shërbimeve dhe/ose Standardeve të Shërbimeve të cilitdo Ofrues të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe/ose cilatdo kompanive ose ndërmarrjeve tjera për ofrimin e shërbimeve publike;
 - (g) Të jenë në pajtim me projekt materialet e dorëzuara për aprovim paraprak nga Rregullatori; dhe
 - (h) Të jenë në pajtim me cilatdo rregulla tjera të përcaktuara për fushatat e informimit publik, shpalljeve dhe/ose reklamave me anë të cilitdo ligj tjetër të aplikueshëm në Kosovë që është i zbatueshëm nga mbikqyrja e mediave dhe/ose autoriteteve tjera kompetente.
- 74.3 74.3 Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të koordinojnë fushatat e tyre për informim publik me fushatat për informim publik të drejtuara nga Rregullatori në pajtim me Nenin 73 që përcaktohet nga Rregullatori.

PJESA 10 ZBATIMI DHE DËNIMET

Kapitulli 1 Zbatimi nga Rregullatori

Neni 75 : Zbatimi

- 75.3 Rregullatori duhet të monitorojë respektimin e kësaj Rregull në bazë të raporteve të dërguara nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave kohë pas kohe siç përcaktohet nga Rregullatori në pajtim me Nenin 76 të mëposhtëm.
- 75.1 Rregullatori gjithashtu duhet të monitorojë përputhshmërinë me këtë Rregull me anë të inspektimeve dhe analizave dhe me anën e raporteve të dërguara nga entitetet tjera dhe autoritetet tjera publike.

Kapitulli 2 Raportet dhe Regjistrimet

Neni 76 : Regjistrimet dhe Raportet

- 76.1 Secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pregaditë dhe të dorëzojë raportet tek Rregullatori në formën e përshkruar dhe brenda intervaleve të specifikuara nga Rregullatori kohë pas kohe.
- 76.2 Gjatë dymbëdhjetë (12) muajve të parë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të dorëzojë tek Rregullatori jo më vonë se dita e pesëmbëdhjetë (15) e muajit pasues raportin e Progresit në formatin i cili është i dhënë në shtojcën e kësaj Rregulle.
- 76.3 Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle dhe më pas në mënyrë periodike, secili Ofrues i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të pregaditë dhe të dërgojë raportet si në vijim:
- (a) Një raport tremujor me datë dorëzimi ditën e njëzetë (20) të muajve prill, korrik, tetor dhe janar për muajt e mëparshëm në formatin e specifikuar nga Rregullatori kohë pas kohe dhe i cili përmbledhë të dhënat në lidhje me Kontratën e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave, lëshimin dhe inkasimin e Faturave, lëshimin dhe përputhshmërinë e Kartës së Konsumatorëve; dhe
 - (b) Raportin vjetor për Konsumatorët e vet duke shfaqur përmbushjen e detyrave kundrejt niveleve të referimit të krijuara nga Rregullatori në konsultim me Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.
- 76.4 Të gjitha shënimet dhe raportet e kërkuara si në vijim të këtij Neni duhet të mbahen dhe ruhen në selinë e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave dhe duhet të jenë në dispozicion gjatë orarit të rregullt të punës për kontrollë nga Rregullatori.
- 76.5 Të gjitha shënimet dhe raportet e kërkuara si në vijim të këtij Neni duhet të organizohen dhe të mbahen nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për një periudhë prej së paku dy (2) viteve të plota kalendarike në lidhje me përmbushjen e kërkesave të Rregullatorit.

Kapitulli 3 Ankesat

Neni 77 : Ankesat

77.1 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të ankohet te Komisioni i Shqyrtimeve i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/49 e datës 26 Nëntor 2004, mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimit të Ujit dhe Mbeturinave ndaj cilatdo vendimeve mbi zbatueshmërinë e kësaj Rregulle.

77.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave gjithashtu mund të ankohet në gjyqet e Kosovës për cilindo vendim të Komisionit të Shqyrtimeve që është ndërmarrë ndaj cilatdo vendimeve konkrete për zbatueshmërinë e kësaj Rregull ose cilatdo pjesëve të saj në pajtim me me Rregulloren e UNMIK-ut te referuar në nën-Nenin 77.1 të lartëshënuar.

Kapitulli 4 Kundërvajtjet dhe Gjjobat

Neni 78 : Kundërvajtjet dhe Gjjobat

Gjjobat duhet të vendosen në pajtim me procedurat e krijuara në Rregullën Mbi Vendosjen e Gjjobave nga Rregullatori ashtu si lëshohen, përmirësohen dhe/ose plotësohen nga Rregullatori kohë pas kohe.


PJESA 11 TË NDRYSHME

Neni 79 : Gjuhët

- 78.1 Kjo Rregull lëshohet dhe publikohet në tri verzione të shkruara në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë, respektivisht:
- (f) Anglisht;
 - (g) Shqip; dhe
 - (h) Serbisht
- 78.2 Në rast të ndonjë mos përputhjeje në mes të versioneve në të cilat kjo Rregull është lëshuar, versioni në gjuhën Angleze do të mirret si bazë.

Neni 80 : Hyrja në Fuqi

- 79.1 Kjo Rregull duhet të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së nënshkrimit.
- 79.2 Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave duhet të lidhë Kontratën e Shërbimit me të gjithë Konsumatorët e vet në Zonën e Shërbimit brenda katër (4) muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle.


Paulino Brillhante Santos
Drejtor


Afrim Lajci
Zëvendës Drejtor

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

PËRMBAJTJA MINIMALE E KARTËS SË KONSUMATORËVE

1. Karta e Konsumatorëve

- 1.1. Çka është Karta e Konsumatorëve
- 1.2. Parimi Bazë (Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ofron shërbimet, Konsumatori paguan)
- 1.3. Kush është i Mbuluar me Shërbim dhe Kohëzgjatja e Mbulesës
- 1.4. Modifikimi i Kartës së Konsumatorëve
 - 1.4.1. Shqyrtimi Vjetor nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 1.4.2. Njoftimi i Konsumatorëve për Modifikimet

2. Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave

- 2.1. Çka është Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave
- 2.2. Roli i Zyres Rregullatore të Ujit dhe Mbeturinave
- 2.3. Metoda me të cilën mund të kontaktohet Rregullatori
- 2.4. Rregullat e lëshuara nga Rregullatori
 - 2.4.1. Rregulla mbi Licensimin e Ofruesve të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 2.4.2. Rregulla mbi Standardet e Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimin të Mbeturinave në Kosovë
 - 2.4.3. Rregulla mbi Vendosjen e Tarifave për Shërbime për Ofruesit e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 2.4.4. Rregulla mbi Kartën e Konsumatorëve
 - 2.4.5. Rregulla mbi Faljen e Borxheve të Vjetra

3. Të Drejtat e Konsumatorëve

- 3.1. E Drejta e Mos-Diskriminimit
- 3.2. E Drejta për të Pranuar Shërbime për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 3.2.1. Niveli i Pritur i Shërbimeve
 - 3.2.2. Tarifat dhe Taksat e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
- 3.3. E Drejta për t'u Informuar
 - 3.3.1. Kopja e Kartës së Konsumatorëve
 - 3.3.2. Faturat e Kaluara dhe Historiku i Pagesës
 - 3.3.3. Raporti i Operimeve dhe Përmbushja e Detyrave
 - 3.3.4. Raporti Vjetor mbi Përputhshmërinë me Kartën e Konsumatorëve
- 3.4. E Drejta për të Pasur Qasje dhe Mbrojtja e të Dhënave të Konsumatorëve në Regjistrin e Konsumatorëve
- 3.5. E Drejta për Faturim të Drejtë dhe Transparent
- 3.6. E Drejta për Aranzhimet e Pagesës
- 3.7. E Drejta për t'u Ankuar
 - 3.7.1. Regjistrimi i Ankesës
 - 3.7.2. Përkjekjet e Duhura për Zgjidhjen e Ankesave
 - 3.7.3. Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
- 3.8. E Drejta për të Kërkuar Identifikimin e Duhur

3.9. E Drejta për të Zgjedhur Gjuhën

4. Obligimet e Konsumatorëve

4.1. Obligimi për të Lidhë Kontratën e Shërbimit

4.1.1. Çka është Kontrata e Shërbimit

4.1.2. Përbajtja e Kontratës së Shërbimit

4.1.3. Përbushja e Kontratës së Shërbimit

4.1.4. Modifikimi në Kontratën e Shërbimit

4.2. Obligimi i shfrytëzimit Ekskluziv të Shërbimeve nga Ofruesi i Caktuar për Grumbullimin e Mbeturinave

4.3. Obligimi për të Bashkëpunuar në Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

4.4. Obligimi për të Paguar Faturat

4.4.1. Metodatat e Pagesës

4.4.2. Parapagimet e Detyrueshme

4.4.3. Depozitet për Paisje

4.4.4. Pagesa e Kamatës

4.4.5. Vendi për të Marrë dhe Paguar Faturat

4.5. Obligimi për të Ofruar Qasjen

4.6. Obligimi për të Respektuar Pasuritë e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

4.7. Obligimi për të Njoftuar mbi Ndryshimet në Fakte dhe Rrethana

5. Të Drejtat e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

5.1. E Drejta e Faturimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

5.2. E Drejta për të Pranuar Pagesën për Faturat

5.3. E Drejta e Ekskluzivitetit në Zonën e Shërbimit

5.4. E Drejta e Qasjes

5.4.1. Aspektet e Përgjithëshme të Qasjes

5.4.2. Njoftim dhe Koha e Qasjes

5.4.3. Për Inspektim

5.4.4. Të Dërgoj Faturën dhe Të Mbledhë Pagesaën

5.4.5. Të Mirëmbajë Paisjet

5.4.6. Të Menaxhoj Emergjencat

6. Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

6.1. Obligimi i Pajtueshmërisë me Kushtet e Licencës së Shërbimit

6.2. Obligimi për Mos-Diskriminim

6.3. Obligimi i Përgaditjes dhe Shpërndarjes së Kartelës së Konsumatorëve

6.4. Obligimi për Ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

6.5. Obligimi i Informimit të Konsumatorëve

6.6. Obligimi i Raportimit

6.6.1. Të Konsumatorëve

6.6.2. Të Zyres Rregullatore për Ujë dhe Hedhurina

6.7. Obligim i Mbajtjes së Rexhistrit të Konsumatorëve

6.7.1. Përbajtja e Rexhistrit të Konsumatorëve

6.7.2. Kufizimi në Informata të Rexhistrit të Konsumatorëve

6.7.3. Sigurimi dhe Mbrojtja e të Dhënave të Konsumatorëve

6.8. Obligimi i Faturimit të Konsumatorëve për Shërbimet e Ofruara të Grumbullimit të Mbeturinave

6.8.1. Gjuha e Faturimit

6.8.2. Përbajtja e Faturimit

- 6.8.3. Konsumatori i Njëjtë/Llogaritë e Shumëfishta të Faturimit
 - 6.8.4. Vërejtja Përkujtuese për Pagesë të Faturës
 - 6.8.5. Përshtatjet dhe Korrigjimet e Faturave
 - 6.8.6. Dënimet për Pagesat me Vonesë
 - 6.8.7. Dënimet për Mos Pagesë
 - 6.9. Obligimi i Pranimit dhe i Adresimit të Ankesave të pranuar të Konsumatorëve
 - 6.10. Obligimi i Ofrimit të Përzgjedhjes së Gjuhëve
- 7. Kontaktimi i Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave**
- 7.1. Kontaktimi i Informatave të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 7.1.1. Ofruesi Lokal i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 7.1.2. Ofruesi Regjional i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
 - 7.2. Pyetjet e Konsumatorëve
 - 7.3. Emergjencat
- 8. Tarifat e Shërbimeve dhe Taksat**
- 8.1. Vendosja e Tarifës së Shërbimit
 - 8.2. Shqyrtimi dhe Aprovimi nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina
 - 8.3. Njoftimi i Tarifave të Shërbimit
 - 8.4. Njoftimi mbi Ndryshimet në Tarifat e Shërbimit
- 9. Raportet për Konsumatorët**
- 9.1. Historiku i Faturave të Mëparme
 - 9.2. Përbajtja e Historikut të Faturave të Mëparme
 - 9.3. Taksat e Prodhimit të Historikut të Faturave të mëparme
 - 9.4. Raportimet e Operimeve
 - 9.5. Raporti mbi Shpenzimet Operative
 - 9.6. Raporti i Përbushjes Operative
 - 9.7. Raporti Vjetor i Përbushjes me Kartelën e Konsumatorëve nga Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

SHTOJCA 2

PËRMBAJTJA MINIMALE E KONTRATËS SË SHËRBIMIT

1. Dispozitat e Përgjithshme

1.1. Deklarata Hyrëse

1.1.1. Deklarata hyrëse e cila deklaron qartë se palët kanë lidhë Kontratën e Shërbimit, qëllimin e lidhjes së një Kontrate të tillë të Shërbimit, emrat e secilës palë në Kontratën e Shërbimit dhe datën kur Kontrata e Shërbimit do të fillojë ose të bëhet e zbatueshme duke përfshirë obligimin e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave të ofrojë Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave dhe obligimin e Konsumatorëve për të paguar për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

1.2. Kohëzgjatëja

1.2.1. kohëzgjatëja dhe data e ndërprerjes së Kontratës së Shërbimit

1.3. Autoriteti për të Kërkuar Kontratën e Shërbimit

1.3.1. Referenca që Kontrata e Shërbimit është ekzekutuar si pasuese e kërkesave të Rregullës së Zyres Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina mbi Kartën e Konsumatorëve për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

1.4. Hollësitë e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

1.4.1. Adresa e hollësishme e Lokacionit për pranimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ose ku është i vendosur Kontejneri Komunal që shfrytëzohet nga Konsumatori.

1.4.2. Klasifikimi i Konsumatorëve dhe Kategoria e aplikueshme e Tarifës së Shërbimit

1.4.3. Lloji i Shërbimit për Grumbullimin e Mbeturinave që duhet të ofrohet në atë lokacion

1.4.4. Ditët e javës, koha dhe shpeshtësia me të cilën duhet të ofrohen Shërbimet për Grumbullimin e Mbeturinave

1.4.5. Obligimi i Konsumatorëve për të ofruar qasje sipas nevojës

1.4.6. Kushtet e veçanta ose nevojat lidhur me shërbimin që i ofrohet lokacionit

1.4.7. Referimi në Rregullën e Zyres Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina mbi Standardet e Shërbimit për Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

1.4.8. Shuma e cila duhet të Faturohet në baza mujore tek Konsumatorët dhe shpeshtësia e Faturimit

1.4.9. Vonesa kohore brenda së cilës Konsumatori duhet të jetë i obliguar të paguajë shumën në Faturë pas datës së Faturimit

1.4.10. Deklarata në fuqi se Konsumatori duhet të bashkëpunojë me Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave në mënyrë të duhur dhe efikase.

2. Hollësitë e Palëve në Kontratën e Shërbimit

2.1. Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave

- 2.1.1. Emri i plotë, adresa dhe numri i telefonit kryesor
- 2.1.2. Numri i telefonit ku Konsumatori mund të paraqet ankesat
- 2.1.3. Adresa ku Konsumatori mund të marrë dhe kryejë pagesën për Faturën

2.2. Konsumatori

- 2.2.1. Emri dhe adresa e plotë e Konsumatorëve ku duhet të dërgohen Faturat nga ana e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave
- 2.2.2. Emri dhe numri i telefonit të kontakt personit
- 2.2.3. Numri i telefonit ku Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave mund të kontaktojë Konsumatorin

3. Tarifat dhe Taksat

3.1. Deklarata për Tarifat e Shërbimit

- 3.1.1. Deklarata në fuqi se taksa e Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave është në pajtim me Tarifat e Shërbimit të aprovuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina dhe se është e kundërligjshme nëse Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave vepron ndryshe.
- 3.1.2. Deklarata në fuqi se Konsumatori mundet një herë në vit dhe falas të kërkojë një kopje të Tarifave të Shërbimit të aprovuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina dhe se Konsumatori mund të shqyrtojë në çdo kohë Tarifat e Shërbimit në fjalë gjatë orarit të rregullt të punës në zyrën afariste të Ofruesit të Shërbimeve.

4. Parapagimet dhe Garancionet

- 4.1. Njohja se nga Konsumatori është kërkuar të bëjë Parapagimin e Detyrueshëm, shumën e parapagimit si dhe periudhën që do ta mbulojë parapagimi nëse aplikohet.
- 4.2. Njohja se është kërkuar nga Konsumatori të bëjë Depozitin për Paisje, shumën e atij garancioni dhe datën deri me kur ai garancion do të mbahet
- 4.3. Në rast se është bërë Parapagimi i Detyrueshëm ose Parapagimi për Paisje, deklarata në fuqi se Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka spjeguar rregullat dhe kushtet që i shoqërojnë ato pagesa si dhe garancionet për Konsumatorin.

5. Të Drejtat e Konsumatorëve

- 5.1. Deklaratën në fuqi se Të Drejtat dhe Obligimet e Konsumatorëve dhe të Ofruesit të Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave janë të listura në hollësi në Kartën e Konsumatorëve.
- 5.2. Deklaratën në fuqi se Ofruesi i Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave ka dorëzuar një kopje të Kartës së Konsumatorëve në kohën e nënshkrimit të kësaj Kontrate të Shërbimit dhe që Konsumatori e vërteton pranimin e kopjes në fjalë.

6. Të Ndryshme

- 6.1. Deklaratën në fuqi se Konsumatori duhet të informojë Ofruesin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave për cilatdo ndryshime të cilat mund të godisin kategorinë e Konsumatorëve ose kryerjen e cilatdo veprimtarive që kanë të bëjnë me ofrimin e Shërbimeve për Grumbullimin e Mbeturinave.

- 6.2. Deklaratën në fuqi se Kontrata e Shërbimit nuk mund të i transferohet palës së tretë
- 6.3. Deklaratën që përshkruan cilatdo kushte të ndërprerjeve si dhe obligimet e Konsumatorëve për të paguar cilatdo Fatura të papaguara pas ndërprerjes.
- 6.4. Ligji i Aplikueshëm